



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde



KORRUPSIONI SI SHKELJE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

Autore: Arrita Reznqi

Ekipi redaktues: Ehat Miftaraj dhe Betim Musliu

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.



RRETH IKD

Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Ilaz Agushi, Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Dhjetor, 2025

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1.	Përmbledhja ekzekutive	4
2.	Kuptimi i të drejtave të njeriut, korrupsionit dhe ndërlidhja e tyre	5
3.	Ndikimi i korrupsionit në të drejtat e njeriut	6
4.	Roli i të drejtave të njeriut në politikat kundër korrupsionit.....	8
5.	Dimensionet e të drejtave të njeriut në luftën kundër korrupsionit	9
5.1.	Mbrojtja e sinjalizuesve	9
5.2.	Kufizimet e kundërligjshme të të drejtave	10
5.3.	Ruajtja e demokracisë dhe e sundimit të ligjit	11
6.	Integrimi evropian si mjet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në luftën kundër korrupsionit 11	
7.	Perspektiva për Kosovën bazuar në kornizën ligjore dhe institucionale	12
8.	Rekomandimet	15

1. Përmbledhja ekzekutive

Në këtë raport IKD trajton marrëdhënien ndërmjet korrupsionit dhe të drejtave të njeriut, ku fillimisht sqaron se të drejtat e njeriut janë ndërtuar mbi raportin shtet-qytetar, ku shteti ka detyrimin të respektojë, mbrojtë dhe përmbushë të drejtat e individit. Korrupsioni, në anën tjetër, konceptohet si krim i zyrtarëve publik me resurset publike dhe trajtohet kryesisht brenda fushës penale. Kjo ndarje ka bërë që për shumë kohë korrupsioni dhe të drejtat e njeriut të perceptohen si fusha të ndara, me mekanizma të ndryshëm institucionalë dhe juridikë.

Megjithatë zhvillimet e kohëve të fundit në nivel të Kombeve të Bashkuara, organizatave të tjera ndërkombëtare, akademikëve dhe institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut, po e sfidojnë këtë ndarje. Edhe pse praktika gjyqësore ndërkombëtare ende nuk e ka njohur në mënyrë eksplicite “të drejtën për të qenë i lirë nga korrupsioni” si të drejtë të veçantë, ekzistojnë elemente të qarta ndërlidhëse, për çka edhe në diskursin ndërkombëtar, po zhvillohet një qasje e re juridike që e sheh korrupsionin si shkelje e të drejtave të njeriut.

Në pjesën analitike, IKD shpjegon se korrupsioni ndikon në ushtrimin e të drejtave të njeriut, siç edhe argumenton se integrimi i perspektivës së të drejtave të njeriut në politikat kundër korrupsionit e thellon dhe e bën më efektive luftën kundër korrupsionit. Në vend që korrupsioni të shihet vetëm si çështje penale, ai trajtohet si problem i qeverisjes, transparencës dhe integritetit institucional, me pasoja të drejtpërdrejta në jetën e qytetarëve. UNCAC kërkon nga shtetet të promovojnë transparencën, pjesëmarrjen publike, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe kompensimin e dëmit, ndërsa instrumentet si KEDNJ dhe CEDAW vendosin standarde të detyrueshme për barazinë para ligjit, ndalimin e diskriminimit dhe qasjen në drejtësi.

IKD identifikon tri dimensione kyçe të angazhimit në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit i cili pos që ruan paranë publike, mbron edhe të drejtat e njeriut, ku përfshihen mbrojtja e sinjalizuesve, parandalimi i kufizimeve të kundërligjshme të të drejtave dhe ruajtja e demokracisë dhe e sundimit të ligjit. Këto ilustronë në mënyrë konkrete se si standardet e të drejtave të njeriut mund të shërbejnë edhe si mjet për ta matur dhe sfiduar korrupsionin në praktikë.

Kurse, integrimi evropian cilësohet jo vetëm proces politik, por edhe mekanizëm substancial për forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut në kontekstin e luftës kundër korrupsionit.

Në fund, IKD vlerëson se Kosova, me një kornizë kushtetuese relativisht të avancuar dhe me obligime ndërkombëtare të qarta në kuadër të procesit të integritetit evropian, ofron terren të përshtatshëm për zhvillimin e perspektivës ku ndërlidhja e korrupsionit dhe të drejtave të njeriut merr kuptim më të ngushtë. Përfshirja e instrumenteve ndërkombëtare në Kushtetutë, dispozitat e Kodit Penal që lidhin korrupsionin me të drejtat e njeriut, si dhe roli potencial i gjykatave, Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, krijojnë mundësi reale për avancimin e kësaj perspektive. Një qasje e tillë e detyron shtetin të veprojë me standarde më të larta të transparencës dhe integritetit, duke garantuar mbrojtje efektive për qytetarët sa herë që korrupsioni cenon të drejtat e tyre themelore.

2. Kuptimi i të drejtave të njeriut, korrupsionit dhe ndërlidhja e tyre

Të drejtat e njeriut përbëjnë një sistem normativ universal që u garanton individëve liri themelore, barazi dhe mbrojtje kundër ndërhyrjeve arbitrare të shtetit. Ato janë të kodifikuara në instrumentet kryesore ndërkombëtare, përfshirë Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe atë për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, apo edhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Dhe përbëjnë të drejta që i kemi vetëm sepse ekzistojmë si qenie njerëzore.¹ Në thelb, të drejtat e njeriut paraqesin kufizimet e shtetit në raport me qytetarët. Kështu është vepruar edhe në rastin e Kushtetutës së Kosovës, ku të drejtat e njeriut përbëjnë pothuajse thelbin e saj.

Ndërsa, korrupsioni, në anën tjetër, është përkufizuar kryesisht si abuzim i pozitës publike për përfitim privat. Sipas Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC), shtetet janë të obliguara të parandalojnë, hetojnë dhe sanksionojnë forma të ndryshme të korrupsionit, përfshirë ryshfetin, përvetësimin e fondeve publike, konfliktin e interesit dhe pasurimin e paligjshëm.² Në kontekstin juridik tradicional, korrupsioni trajtohet si vepër penale, më shumë sesa si çështje që ka implikime të drejtpërdrejta në të drejtat e individit.

Kjo ka bërë që për shumë vite korrupsioni dhe të drejtat e njeriut të perceptohen si fusha të ndara, me mekanizma institucionalë dhe juridikë të ndryshëm. Arsyeja pse këto dy fusha janë parë historikisht si të ndryshme lidhet me natyrën e marrëdhënies që secila adreson. Të drejtat e njeriut janë ndërtuar mbi raportin shtet-qytetar, ku shteti ka detyrimin të respektojë, mbrojë dhe përmbushë të drejtat e individit. Korrupsioni, në anën tjetër, konceptohet si krimi i zyrtarëve publik me resurset publike.

Përkundër dallimit të këtyre dy fushave, këto koncepte kanë ndërlidhje ndërmjet vete. Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) e trajton korrupsionin dhe të drejtat e njeriut përmes dy linjave komplementare:

1. Sigurimi që përpjekjet dhe përgjigjet kundër korrupsionit të jenë në përputhje me detyrimet për të drejtat e njeriut dhe të kenë një qasje të orientuar te viktimat dhe
2. Hetimi i ndikimeve negative të korrupsionit mbi të drejtat e njeriut, me fokus të veçantë të të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, duke përdorur një qasje që përfshin parandalimin, administrimin efektiv të drejtësisë dhe sigurimin e reparacionit për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut të shkaktuara nga veprat e lidhura me korrupsionin dhe reagimet kundër korrupsionit.³

¹ Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), “What are human rights?” (shih linkun: <https://www.ohchr.org/en/what-are-human-rights>).

² Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit (UNCAC), Nenet 15–23, që trajtojnë format klasike të korrupsionit.

³ Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), “Approach to corruption and human rights” (shih linkun: <https://www.ohchr.org/en/good-governance/corruption-and-human-rights>).

Në linjë me këtë, zhvillimet e viteve të fundit tregojnë se shumë organizata ndërkombëtare, akademike dhe institucione kombëtare të të drejtave të njeriut kanë nisur të eksplorojnë qasjen që e sheh korrupsionin si shkelje të të drejtave të njeriut. Kjo qasje nuk është e vetëkuptueshme dhe nuk ka qenë pjesë e traditës juridike të deritanishme në shumicën e shteteve. Në fakt, është qasje e re që po fiton terren, duke qenë se e vlerëson korrupsionin si fenomen që nuk e dëmton vetëm funksionimin e institucioneve, por cenon drejtpërdrejt ose tërthorazi të drejtat dhe liritë e qytetarëve.

3. Ndikimi i korrupsionit në të drejtat e njeriut

Korrupsioni përbën një nga sfidat më serioze për sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut. Në të kuadër të kornizës ligjore në Kosovë, korrupsioni trajtohet përmes fushës penale, mirëpo ndikimi i tij shtrihet shumë më gjerë, pasi prek edhe sferën e të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore, duke kontribuar në krijimin e pabarazive strukturore, diskriminimit dhe mungesës së besimit në institucione.

Në diskursin ndërkombëtar, po zhvillohet një qasje e re juridike që e sheh korrupsionin si shkelje e të drejtave të njeriut.

Fillimisht, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) thekson se korrupsioni, ndër të tjera, ndikon në shkeljen e të drejtave të njeriut.⁴ Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut miratoi në korrik 2025 një rezolutë historike mbi ndikimin negativ të korrupsionit në të drejtat e njeriut.⁵ Kjo rezolutë përcakton një kornizë të qartë deskriptive dhe normative për të kuptuar mënyrën se si korrupsioni cenon të drejtat e njeriut dhe detyrimet që rrjedhin për shtetet dhe akterët e tjerë. Kjo rezolutë shënon një hap të rëndësishëm dhe përkrahë më tutje perceptimin se korrupsioni paraqet kërcënim sistemik ndaj të drejtave themelore dhe e vendos këtë çështje në qendër të agjendës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Nëpërmjet kësaj, rezoluta krijon një pikë referimi brenda sistemit të OKB-së për punë dhe angazhime të mëtejshme analitike, ligjore dhe politike, duke hapur rrugën për një integrim më të thelluar të masave kundër korrupsionit në mekanizmat e të drejtave të njeriut dhe në praktikat shtetërore.

Kjo qasje mbështetet në faktin se korrupsioni pengon zbatimin e detyrimeve themelore të shtetit në veçanti për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve. Nëse shteti nuk parandalon, nuk heton dhe nuk sanksionon korrupsionin, atëherë shteti dështon në mbrojtjen e qytetarëve nga pasojat e këtyre krimeve. Rrjedhimisht, në këtë mënyrë, shteti bëhet përgjegjës për shkelje të të drejtave të njeriut. Kësisoj, kjo kuptohet si formë ku korrupsioni ndikon në ushtrimin e të drejtave në mënyrë të shumëfishtë, gjë që nënkupton se nuk ka të bëjë thjesht me abuzimin e pushtetit, por përbën faktor

⁴ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC), parathënia – tekst i Sekretarit të Përgjithshëm, z. Kofi A. Annan.

⁵ Rezoluta e Këshillit të të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara A/HRC/59/L.6, mbi ndikimin negativ të korrupsionit në gëzimin e të drejtave të njeriut.

që kufizon gëzimin efektiv të të drejtave të njeriut. Kjo qasje analitike ndihmon në identifikimin dhe analizimin e rasteve kur një veprim korruptiv shndërrohet në shkelje të të drejtave themelore, duke tentuar ta bëjë të dukshme dhe të matshme lidhjen midis veprimeve korruptive dhe pasojave konkrete në të drejtat e njeriut.

Në literaturën e specializuar është propozuar që korrupsioni të konceptohet përmes një zinxhiri shkakor, ku vlerësohet jo vetëm veprimi korruptiv në vetvete, por edhe mënyra se si ai përhapet në institucione, në shërbime publike apo në procese administrative, deri në pikën ku prek një të drejtë specifike të mbrojtur. Sipas kësaj qasjeje, shkeljet mund të konceptohen në tri kategori: shkelje të drejtpërdrejta, tërthorta dhe të krijuara në distancë.⁶

Në rastet e shkeljeve të drejtpërdrejta, veprimi korruptiv dhe cenimi i të drejtës së njeriut janë të ndërlidhura menjëherë me njëra-tjetrën. Kjo ndodh sidomos kur korrupsioni përdoret si mjet për të cenuar një të drejtë, ose kur shkelja ishte e parashikueshme dhe shteti nuk veproi me kujdes të duhur. Shembulli më tipik është ryshfeti në sistemin e drejtësisë, kur gjyqtarë, prokurorë apo avokatë pranojnë para për të ndikuar rezultatin e një rasti, atëherë dëmtimi i së drejtës për gjykim të drejtë është i menjëhershëm dhe i drejtpërdrejtë. Në këtë rast, korrupsioni nuk është shkak i tërthortë, as faktor kontribuues, por është shkaku kryesor i shkeljes.⁷

Te shkeljet e tërthorta, korrupsioni nuk synon drejtpërdrejt cenimin e të drejtave të njeriut, por krijon kushtet që shkelja të ndodhë. Pra, veprimi korruptiv është një hallkë e rëndësishme në zinxhirin e ngjarjeve, por jo shkaku final. Një shembull lidhet me të drejtën për ushqim. Nëse një kompani arrin të marrë leje për prodhim ushqimor përmes ryshfetit, pa i përmbushur standardet e cilësisë dhe sigurisë, atëherë korrupsioni krijon kushtet që në treg të qarkullojnë produkte të pasigurta, të cilat mund të dëmtojnë shëndetin e një numri të madh qytetarësh. Në këto raste, korrupsioni nuk synon në mënyrë eksplicite shkeljen, mirëpo e mundëson atë, duke e lënë rrezikun të veprëj lirshëm, ndërsa qytetarët bëhen viktimë të një sistemi të dështuar të mbikëqyrjes dhe rrjedhimisht konsumojnë produkte jo të sigurta.⁸

Shkeljet në distancë ndodhin kur korrupsioni është vetëm një nga disa faktorët që së bashku krijojnë një situatë të dëmshme. Këtu korrupsioni vepron si katalizator në një zinxhir më të gjerë zhvillimesh politike apo shoqërore. Shembull ilustrues janë praktikat korruptive në proceset zgjedhore. Kur manipulimi i zgjedhjeve cenon besimin e qytetarëve në rezultate dhe legjitimitet të institucioneve, mund të pasojnë protesta, tensione, apo në disa raste, ndërhyrje të dhunshme të forcave të sigurisë. Në një situatë të tillë, korrupsioni në procesin zgjedhor nuk e shkakton drejtpërdrejt shkeljen e të drejtës për tubim paqësor apo të ndalimit të përdorimit disproporcional të forcës, por krijon kontekstin dhe terrenin që lejon përshkallëzimin e situatës në shkelje serioze të të drejtave civile.⁹

⁶ International Council on Human Rights Policy, "Corruption and Human Rights: Making the Connection", 2009. International Council on Human Rights Policy. Fq. 26-28.

⁷ Po aty, fq. 27.

⁸ Po aty, fq. 27-28.

⁹ Po aty, fq. 28-29.

Nga ana tjetër, në doktrinën juridike ekzistojnë edhe qasje që nuk e mbështesin plotësisht kategorizimin e mësipërm, pasi vlerësojnë se logjika e së drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut fokusohet më shumë tek detyrimet e shtetit, sesa tek distanca shkakore në mes të korrupsionit dhe pasojave. Sipas kësaj perspektive, pyetja kryesore nuk është sa “afër” apo “larg” është veprimi korruptiv nga shkelja, por nëse shteti ka dështuar në mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve nga korrupsioni. Kësisoj, nëse korrupsioni çon në situata ku qytetarëve u mohohen të drejta të mbrojtura, atëherë, sipas kësaj qasjeje, kemi shkelje të të drejtave të njeriut, pavarësisht nga fakti nëse korrupsioni ka qenë shkak i afërt apo i largët i dëmit.¹⁰

IKD konsideron se kjo mënyrë e interpretimit është e vlefshme edhe në kontekstin e Kosovës, sepse e vendos përgjegjësinë aty ku juridikisht i takon, te shteti dhe institucionet e tij. Kjo qasje është veçanërisht e rëndësishme në një sistem ku korrupsioni është i përhapur dhe ku qytetarët kanë pak mundësi reale për të ndikuar në proceset vendimmarrëse.

Duke u kombinuar me qasjen e zinxhirit shkakor, kjo perspektivë mundëson një kuptim më të plotë të mënyrës se si korrupsioni dëmton të drejtat themelore dhe ndihmon në identifikimin e hapësirave konkrete për reforma.

4. Roli i të drejtave të njeriut në politikat kundër korrupsionit

Integrimi i perspektivës së të drejtave të njeriut në politikat kundër korrupsionit nuk e zëvendëson qasjen klasike të ndjekjes penale, hetimeve dhe masave administrative, por përkundrazi, e thellon, e zgjeron dhe e bën më efektive. Kjo qasje e vendos theksin te individi dhe tek detyrimi i shtetit për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve të saj. Këtu, natyrshëm hyn obligimi për të mbrojtur të drejtat e tyre nga veprimet korruptive.

Rëndësia e kësaj qasjeje vërehet në mënyrën se si ndërthuren instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) dhe kushtetutat e shteteve përkatëse. Ndërthurja e kësaj kornize me detyrimet që burojnë nga UNCAC krijojnë një bazë më të fortë ligjore për ndjekjen e korrupsionit. Në këtë kuptim, të drejtat e njeriut kanë rol transformues, meqë nuk e shohin korrupsionin vetëm si veprim individual, por si problem të qeverisjes, mungesës së transparencës dhe dobësisë së integritetit institucional.

Në vend që të luftohet korrupsioni vetëm në sferën penale, qasja e të drejtave të njeriut e ndërton rezistencën ndaj korrupsionit përmes demokracisë funksionale, qasjes në drejtësi, transparencës dhe barazisë. Kjo qasje ndikon në zgjerimin e konceptit të viktimës, krijimin e përgjegjësisë më të gjerë për shtetin dhe e bën luftën kundër korrupsionit më të ndjeshme ndaj ndikimit që korrupsioni ka mbi jetën e qytetarëve.

¹⁰ Martine Boersma, “Corruption: A Violation of Human Rights and a Crime Under International Law?”, 2012. Fq. 196-200.

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) kërkon nga shtetet, ndër të tjera, që të promovojnë transparencën dhe pjesëmarrjen publike¹¹, mbrojtjen e sinjalizuesve¹² dhe kompensimin për dëmin e pësuar¹³. Zbatimi i UNCAC-ut në Kosovë, si instrumenti kryesor ndërkombëtar kundër korrupsionit, duhet të shihet edhe si detyrim për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve ndaj korrupsionit. Korrupsioni që kufizon mekanizmat e transparencës, pengon pjesëmarrjen publike ose dekurajon raportimin, në fakt përbën shkelje të të drejtave procedurale të qytetarëve dhe dështim të shtetit në rolin e tij mbrojtës.

Krahas UNCAC-ut, zbatimi i standardeve të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), Konventës për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW) dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare, nuk shërben vetëm për vlerësimin e shtetit në raport me standardet ndërkombëtare, por synon të krijojë kushte reale për drejtësi dhe barazi. Kjo do të thotë se lufta kundër korrupsionit nuk varet vetëm nga kapaciteti i policisë dhe prokurorisë, por mund dhe duhet të mbështetet edhe nga qytetarët, viktimat, organizatat e shoqërisë civile, mediat etj. Nëse kjo logjikë aplikohet në vazhdimësi, presioni institucional ndaj korrupsionit forcohet ndjeshëm dhe rritet mundësia që rastet të dokumentohen, të trajtohen dhe të mos mbesin të pandëshkuara.

5. Dimensionet e të drejtave të njeriut në luftën kundër korrupsionit

Në mënyrë që të rritet fokusi institucional në luftimin e korrupsionit, ky lloj kriminaliteti, pos cenimit të parasë publike (që po ashtu është e mjaftueshme), duhet të fokusohet edhe në fushën e të drejtave të njeriut.

Kjo qasje rrit rëndësinë shoqërore të angazhimit të të gjitha institucioneve, qytetarëve, mënyrës së zbatimit të ligjit etj. në fushat që kontribuojnë në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit. Në linjë me këtë frymë, IKD identifikon tri dimensione kyçe të angazhimit në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit i cili pos që ruan parandë publike, mbron edhe të drejtat e njeriut. Këto dimensione shtrihen kryesisht në mbrojtjen e sinjalizuesve, kufizimet e kundërligjshme të të drejtave të njeriut dhe ruajtjen e demokracisë dhe të sundimit të ligjit.

Këto ilustronë në mënyrë konkrete se si standardet e të drejtave të njeriut mund të shërbejnë edhe si mjet për ta matur dhe sfiduar korrupsionin në praktikë.

5.1. Mbrojtja e sinjalizuesve

Mbrojtja e sinjalizuesve është një garanci thelbësore demokratike që shërben për të siguruar transparencë, llogaridhënie dhe pjesëmarrje publike në mbikëqyrjen e institucioneve. Në thelb, kjo përbën një mekanizëm kyç për parandalimin e korrupsionit. Nga perspektiva e të drejtave të njeriut,

¹¹ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC), neni 13.

¹² Po aty, neni 33.

¹³ Po aty, neni 35.

mbrojtja e sinjalizuesve ngërthen nevojën e lidhjes së saj me të drejtën për lirinë e shprehjes, të drejtën për liri dhe siguri dhe të drejtën për mjet juridik efektiv. Nëse këto të drejta kufizohen, sistemi krijon një ambient pengues, ku raportimi i korrupsionit perceptohet si rrezik individual, e jo si obligim moral apo ligjor për të mbrojtur interesin publik.

Mungesa e mbrojtjes efektive për sinjalizuesit, nënkupton se sistemi humbet një instrument jetik të mbrojtjes së të drejtave. Kështu, korrupsioni mbetet i fshehur, institucionet nuk informohen për shkeljet e brendshme dhe individët që ekspozojnë keqpërdorimet rrezikojnë hakmarrje, presion ose shkarkim nga puna. Në këtë kuptim, dështimi i shtetit për të ofruar mbrojtje efektive të sinjalizuesve është shkelje strukturore që lejon zhvillimin e korrupsionit dhe shtrirjen e pasojave të tij në të drejtat e njeriut.

Në rastin e Kosovës, ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve paraqet një aspekt pozitiv në drejtim të mbrojtjes ligjore për këtë kategori, mirëpo zbatimi i mirëfilltë i tij në praktikë vazhdon të mbetet sfidë.¹⁴ Kjo bën që sinjalizuesit potencialë të hezitojnë të reagojnë, duke e lënë kështu një pjesë të konsiderueshme të rasteve të korrupsionit jashtë vëmendjes institucionale dhe duke krijuar një ambient ku parandalimi i korrupsionit mbetet i dobët.

5.2. Kufizimet e kundërligjshme të të drejtave

Një formë më e fshehtë e ndikimit të korrupsionit në të drejtat e njeriut shfaqet përmes kufizimeve të kundërligjshme të lirive themelore. Shpesh këto kufizime arsyetohen me sigurinë publike, ruajtjen e rendit ose mbrojtjen e interesit shtetëror, duke u shfaqur si formalisht të ligjshme, por në thelb janë metoda që reduktojnë hapësirën demokratike dhe mundësojnë korrupsionin në prapaskenë.

Në praktikë, këto mund të ndikojnë në kufizimin e zërave kritikë dhe për të penguar kontrollin demokratik mbi pushtetin, duke kufizuar lirinë e mediave, ose duke penguar punën e shoqërisë civile dhe qasjen në informacione. Kufizimet e tilla konsiderohen joproporcionale në raport me qëllimin e shpallur dhe përbëjnë shkelje të lirisë së shprehjes¹⁵ dhe lirisë së tubimit dhe organizimit¹⁶, të lirisë së asociimit etj.¹⁷ Raste të tilla kryesisht vërehen në formën se si zyrtarët institucional i qasen transparencës, llogaridhënies, përdorimi i padive strategjike kundër pjesëmarrjes në publik (SLAPP) kundër gazetarëve apo aktivistëve të shoqërisë civile, presioneve politike ndaj këtyre akterëve, pengimit të qasjes në dokumente zyrtare apo klasifikimit të informacioneve në sektorë të ndjeshëm.

Në këto rrethana, kufizimi i të drejtave nuk është vetëm shkelje e të drejtave dhe lirive themelore, por edhe një formë e tërthortë e fshehjes së korrupsionit. Sa më shumë të ngushtohet hapësira për kritika dhe llogaridhënie, aq më e lehtë bëhet normalizimi i korrupsionit dhe vështirësohet

¹⁴ IKD, “Përmbushja e premtimit për sinjalizuesit”, 2024, fq. 7.

¹⁵ Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), neni 10.

¹⁶ Po aty, neni 11.

¹⁷ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), neni 22.

identifikimi i tij. Në këtë mënyrë, pos se korrupsioni shkel të drejtat e njeriut, shkelja e të drejtave të njeriut e fuqizon korrupsionin dhe kështu krijohet një rreth vicioz. Kjo e bën mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore jo vetëm vlerë kushtetuese, por edhe instrument parandalues kundër korrupsionit.

5.3. Ruajtja e demokracisë dhe e sundimit të ligjit

Në esencë, korrupsioni është antitezë e sundimit të ligjit. Në një shtet demokratik, sundimi i ligjit nënkupton që autoritetet të veprojnë vetëm në përputhje me ligjin, ligjet të zbatohen në mënyrë të paanshme dhe të parashikueshme dhe qytetarët të kenë qasje të barabartë në drejtësi. Korrupsioni i shkatërron të tre këto shtylla.

Nga perspektiva e të drejtave të njeriut, demokracia nënkupton ushtrimin e pushtetit në përputhje me ligjin dhe me respekt të barabartë për çdo qytetar. Neni 24 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili garanton barazinë para ligjit dhe ndalon çdo formë diskriminimi¹⁸, lidhet drejtpërdrejt me këtë realitet. Korrupsioni, në anën tjetër, e cenon në thelb këtë parim duke krijuar trajtim të pabarabartë, favorizim të individëve të lidhur me pushtetin dhe diskriminim ekonomik e institucional. Si rezultat, qytetarët jo vetëm që dëmtohen nga vendimet e padrejta, por humbin edhe besimin në institucionet që supozohet t'i mbrojnë.

Në këtë mënyrë, ruajtja e demokracisë dhe e sundimit të ligjit bëhet kusht paraprak për garantimin e të drejtave të njeriut dhe njëkohësisht, mjet i fuqishëm për parandalimin e korrupsionit. Jurisprudenca e GJEDNJ, përmes rasteve si *Kövesi kundër Rumanisë*¹⁹ ilustron se korrupsioni institucional dhe ndërhyrjet arbitrare në gjyqësor cenojnë jo vetëm parimet e sundimit të ligjit, por edhe të drejtat themelore të palëve në procedurë.

Sa më funksionalë të jenë mekanizmat demokratikë dhe sa më i fortë të jetë sundimi i ligjit, aq më e vështirë bëhet për korrupsionin të zë vend dhe të normalizohet.

6. Integrimi evropian si mjet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në luftën kundër korrupsionit

Integrimi evropian nuk është thjesht proces politik apo diplomatik, por mund të konsiderohet si mjet i rëndësishëm mbrojtës për të drejtat e qytetarëve ndaj korrupsionit dhe abuzimit të pushtetit. Në këtë perspektivë, kërkesat e Bashkimit Evropian (BE) për reforma në fushën e sundimit të ligjit, pavarësisht së gjyqësorit dhe mbrojtjes së të drejtave themelore shihen si instrumente konkrete për forcimin e institucioneve të llogaridhënies.

¹⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 24.

¹⁹ Rasti nr. no. 3594/19 Kövesi kundër Rumanisë, shih linkun: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22appno%22:%5B%223594/19%22%5D,%22itemid%22:%5B%22001-202415%22%5D%7D>.

BE-ja kërkon nga shtetet që të përforcojnë lidhjen midis mbrojtjes së të drejtave dhe integritetit institucional. Përmes Raporteve të Progresit, BE-ja mat dhe vlerëson përparimin e vendit në luftën kundër korrupsionit, që nënkupton se dështimet në luftën kundër korrupsionit nuk shihen vetëm si çështje teknike, por si tregues i mospërputhjes me vlerat dhe standardet themelore të BE-së.

Në kuadër të procesit të integritetit, Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore²⁰ dhe Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria²¹, përcaktojnë dhe vlerësojnë standarde specifike për sa i përket funksionimit të gjyqësorit, luftës kundër korrupsionit, garantimit të të drejtave themelore, lirisë së shprehjes, luftës kundër krimit të organizuar, e sigurimit të llogaridhënies në përgjithësi. Këto standarde e bëjnë zbatimin e të drejtave të njeriut mjet të drejtpërdrejtë për luftën kundër korrupsionit dhe kriter të matshëm për procesin e anëtarësimit.

Procesi i anëtarësimit në BE është i ndërtuar mbi parimin e përmbushjes së standardeve të sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut, si parakusht për progres politik dhe ekonomik. Kjo e detyron një shtet si Kosova të forcojë institucionet e drejtësisë, të mbrojë sinjalizuesit dhe gazetarët dhe të garantojë qasje në informata publike. Nëse këto standarde zbatohen në mënyrë efektive dhe përmbajtësore, e jo vetëm formale, integrimi evropian mund të shërbejë si shtytës i fuqishëm për ndërtimin e një sistemi më rezistent ndaj korrupsionit dhe më të ndjeshëm ndaj të drejtave të qytetarëve.

7. Perspektiva për Kosovën bazuar në kornizën ligjore dhe institucionale

Edhe pse praktika gjyqësore ndërkombëtare ende nuk e ka njohur në mënyrë eksplicite “të drejtën për të qenë i lirë nga korrupsioni” si të drejtë të veçantë, ekzistojnë elemente të qarta ndërlidhëse, të cilat janë trajtuar edhe në pjesët e mësipërme të kësaj analize.

IKD vlerëson se Kosova, me një kornizë kushtetuese relativisht të avancuar dhe me obligime ndërkombëtare të qarta në kuadër të procesit të integritetit evropian, ofron terren të përshtatshëm për zhvillimin e kësaj perspektive.

Fillimisht, Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton të drejtat dhe liritë themelore, duke i vendosur ato në harmoni me instrumentet kryesore ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.²² Përfshirja e Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike (ICCPR) dhe Protokollet e saj, Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW) dhe instrumenteve të tjera ndërkombëtare, bën që mbrojtja e shumë të drejtave të jetë drejtpërdrejtë e zbatueshme. Kështu ekziston bazë normative për adresimin e rasteve në të cilat korrupsioni pengon qasjen në drejtësi, sjell diskriminim ekonomik ose shkel barazinë para ligjit, pasi këto situata mund

²⁰ Shih linkun: https://enlargement.ec.europa.eu/enlargement-policy/conditions-membership/chapters-acquis_en.

²¹ Po aty.

²² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 22.

të lexohen edhe si shkelje të dispozitave kushtetuese dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) ndonëse nuk e përmend korrupsionin në mënyrë eksplicite, ndër të tjera garanton të drejtën për një proces të rregullt²³, të drejtën për mjet efektiv²⁴ dhe ndalimin e diskriminimit²⁵. Në këtë drejtim, nëse gjyqtarët ose prokurorët ndikohen nga interesa politike ose financiare, shkelet parimi i pavarësisë gjyqësore dhe i paanshmërisë.

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), garanton barazinë para ligjit²⁶, të drejtën për qasje të drejtë në gjykata²⁷ dhe të drejtën për pjesëmarrje në çështje publike dhe funksione shtetërore.²⁸ Korrupsioni që favorizon individë, kompani ose parti politike në mënyrë të padrejtë bie ndesh me këto parime dhe e bën shtetin përgjegjës për diskriminim dhe shkelje të barazisë para ligjit.

Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW) ndalon çdo formë diskriminimi ndaj grave dhe kërkon nga shtetet të eliminojnë pengesat strukturore që diskriminojnë gratë në punësim,²⁹ arsim,³⁰ shëndetësi³¹ dhe drejtësi.³² Nëse korrupsioni përdoret si mjet për të kushtëzuar qasjen e grave në të drejtat e tyre, për shembull në pronë, punësim ose shërbime publike, atëherë kemi edhe shkelje të detyrimeve të kësaj Konvente. Mungesa e mekanizmave efektivë për raportim dhe mbrojtje të grave viktime e bën korrupsionin edhe një mjet të dhunës me bazë gjinore, duke e përkeqësuar pozitën e gruas në shoqëri.

Krahas këtyre, Kodi 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës analizuar në kontekstin e figurës së veprave penale, e njeh ndërlidhjen në mes të korrupsionit dhe të drejtave të njeriut. Në kapitullin XVII të KPRK-së janë listuar veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut. Në shumë prej veprave penale që përmban ky kapitull, vepra penale kualifikohet nëse ajo kryhet në keqpërdorim të detyrës zyrtare.³³ Në anën tjetër, vepra penale bazë e korrupsionit, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, e përfshin shkeljen e të drejtave të personit tjetër si një ndër elementet e veprës penale.³⁴

Brenda këtij konfigurimi, edhe gjykatat luajnë rol kyç, prandaj ato duhet të zhvillojnë një praktikë më të konsoliduar të interpretimit të të drejtave të njeriut në rastet që lidhen me korrupsionin. Një qasje e tillë u mundëson gjykatave të vlerësojnë jo vetëm elementet formale të veprimit korruptiv,

²³ Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), Neni 6.

²⁴ Po aty, Neni 13.

²⁵ Po aty, Neni 14.

²⁶ Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), neni 2.

²⁷ Po aty, neni 14.

²⁸ Po aty, neni 25.

²⁹ Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas (CEDAW), neni 11.

³⁰ Po aty, neni 10

³¹ Po aty, neni 12.

³² Po aty, neni 15.

³³ Kodi 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës, Kapitulli XVII – Veprat Penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut.

³⁴ Po aty, neni 414 .

por edhe ndikimin substancial që ky veprim ka në ushtrimin e të drejtave të qytetarëve. Përmes këtij interpretimi, cenimi i të drejtave të njeriut lexohet si element i peshës juridike të rastit, duke e bërë më të qartë përgjegjësinë e shtetit sa herë që korrupsioni prodhon pasoja reale në jetë, qasje në shërbime, barazi dhe drejtësi. Krahas të tjerave, kjo çështje duhet të merret parasysh edhe me rastin e analizimit të qëllimit të dënimit, njëri ndër të cilët është që “të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale”.³⁵

Nëse korrupsioni njihet dhe trajtohet si shkelje e të drejtave të njeriut, kjo do të fuqizonte mekanizmat kombëtarë, përfshirë edhe Institucioni e Avokatit të Popullit (IAP), që të shtrijë analizën e vet në fushën kundër korrupsionit, apo edhe Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (APK) që të shtrijë perspektivën e të drejtave të njeriut në fushën e vet. IAP përmes hetimeve tematike do të mund të shqyrtonte mënyrën se si korrupsioni ndikon në shkeljen e të drejtave të njeriut, përfshirë qasjen në drejtësi, barazinë para ligjit, të drejtat socio-ekonomike dhe fenomenet diskriminuese. Ndërsa, APK në bashkëpunim të ngushtë me IAP-në, mund të zhvillojë një kornizë të specializuar për analizën dhe dokumentimin e rasteve ku korrupsioni manifestohet si shkelje e të drejtave të njeriut, veçanërisht në sektorët me rrezik të lartë si drejtësia, shëndetësia, prokurimi publik, qasja në pronë dhe administrimi lokal. Kjo do të prodhonte një qasje më të fuqishme dhe të integruar ndër-institucionale, duke e krijuar një qasje të re të përgjegjësisë së shtetit dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve.

Njëkohësisht, Strategjia Kombëtare kundër Korrupsionit dhe Plani i saj i Veprimit duhet të reflektojnë këtë qasje të re, duke trajtuar korrupsionin jo vetëm në formë të veprave penale, por edhe si fenomen që cenon drejtpërdrejt të drejtat dhe liritë e individit. Integrimi i kësaj perspektive në dokumentet strategjike do të krijojë një arkitekturë më të fuqishme dhe të qëndrueshme ndër-institucionale, duke e zhvendosur fokusin drejt përgjegjësisë së shtetit dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve.

IKD vlerëson se adoptimi i kësaj perspektive në punën institucionale dhe në dokumentet strategjike do të forcojë ndjeshëm koherencën ndërmjet politikave kundër korrupsionit dhe mekanizmave të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Një qasje e tillë do ta orientonte shtetin drejt standardeve më të larta të transparencës dhe integritetit, ndërsa do të kërkonte nga institucionet që të garantojnë mbrojtje efektive për individin sa herë që korrupsioni cenon të drejtat e tij themelore.

³⁵ Po aty, neni 38.

8. Rekomandimet

1. Gjatë hartimit të legjislacionit, institucionet shtetërore të integrojnë qasjen e të drejtave të njeriut në politikat kundër korrupsionit.
2. Në kontekstin e integritetit evropian, institucionet shtetërore të Kosovës të përdorin Kapitujt 23 dhe 24 për të avancuar standardet e të drejtave të njeriut si mjet për forcimin e luftës kundër korrupsionit.
3. Gjykatat të zhvillojnë një praktikë më të konsoliduar të interpretimit të të drejtave të njeriut në rastet që lidhen me korrupsionin, në mënyrë që cenimi i të drejtave të lexohet si element substancial në vlerësimin e rasteve.
4. Institucioni i Avokatit të Popullit të zhvillojë hetime tematike që lidhin korrupsionin me shkeljen e të drejtave të njeriut, duke përfshirë qasjen në drejtësi, barazinë para ligjit, të drejtat socio-ekonomike dhe diskriminimin.
5. Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit në bashkëpunim me Institucionin e Avokatit të Popullit të krijojnë një kornizë të veçantë të analizës së rasteve, në të cilën korrupsioni do të identifikohet dhe dokumentohet si shkelje e të drejtave të njeriut, sidomos në sektorë me rrezik të lartë si sistemi i drejtësisë, shëndetësia, prokurimi publik, pronësia dhe qeverisja lokale.
6. Strategjia kombëtare kundër Korrupsionit dhe Plani i saj i Veprimit ta trajtojnë korrupsionin edhe në dimensionin e të drejtave të njeriut.